



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 972/4 prot.

Tiranë, më 30. 07. 2026

V E N D I M

Nr. 208, datë 30. 07. 2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën nr. 126 Regj., datë 21.05.2026, të shtetas F. Xh., kundër Gjimnazit “John F. Kennedy”, Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të *“gjendjes arsimore”¹*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Bazuar në ankesën dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga subjekti ankues, F. Xh., parashtron ndër të tjera se: *“Unë, e nënshkuara F. A. Xh., aktualisht mësuese e lëndës TIK në gjimnazin “John F. Kennedy”, Institut, paraqes këtë kërkesë për rishqyrtimin e vendimit të skualifikimit tim nga procesi i konkurrimit për pozicionin “Nëndrejtor” në këtë institucion arsimor.*

Kam përfunduar studimet Bachelor në degën “Teknologji Informacioni”, pranë Universitetit të Vlorës, Departamenti i Mësuesisë, në vitet 2004 -2007. Në vitin shkollor 2009 - 2010 kam ushtruar detyrën e mësueses provizore në shkollën 9-vjeçare “Qenam”. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, ushtrimi i profesionit të mësuesit kërkonte përfundimin e ciklit të dytë të studimeve dhe pajisjen me licencë për ushtrimin e profesionit. Për këtë arsye, në vitet 2012 - 2014 kam ndjekur dhe përfunduar studimet “Master Profesional në Pedagogji me profil “Didaktikë” me 90 kredite, pranë “Albanian University”. Në atë periudhë programet Master Profesional ofroheshin me 60 ose 90 kredite,

¹ Duke referuar diskriminim në nivel profesional.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

ndërsa ndjekja e një Masteri Shkencor në profil IT nuk do të më jepte titullin “Mësues” dhe nuk do të më mundësonte hyrjen në procesin e licencimit.

Në dhjetor 2014 jam licencuar si “Mësuese Informatike”. Që prej datës 02.10.2015 ushtroj detyrën e mësueses TIK me kohë të plotë dhe kontratë pa afat në arsimin parauniversitar.

Gjatë eksperiencës sime profesionale kam kryer edhe funksione të tjera me përgjegjësi, si:

- Mbikëqyrëse Maturash Shtetërore;
- Administratore PISA;
- Administratore SMIP,
- si dhe angazhime të tjera institucionale.

Në vitin 2020 kam fituar kategorinë “ Mësues i Kualifikuar” pa asnjë pengesë apo konstatim lidhur me vlefshmërinë e formimit tim akademik, ndonëse ndryshimet në ligjin nr. 69/2012 ishin bërë që në vitin 2017. Kjo për shkak se ligji nuk ka fuqi prapavepruese.

Në vitin 2021 kam aplikuar dhe jam shpallur fituese në “Thirrjen V” të CSL.

Në vitet 2022-2023 kam ndjekur “Shkollën e Drejtorëve” dhe jam certifikuar me sukses, në një periudhë kur Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023, ende nuk kishte hyrë në fuqi.

Në janar 2024 mora pjesë në konkurrimet për Drejtor IAP. Në këtë proces:

- ZVAP Tiranë më skualifikoi;
- ndërsa ZVAP Kamëz më kualifikoi,

edhe pse të dy institucionet ishin nën varësinë e DRAP Durrës. Arsyeja e skualifikimit më është komunikuar vetëm verbalisht dhe lidhej me faktin që zotëroj “Master Profesional” me 90 kredite. Kam paraqitur ankesa të njëpasnjëshme administrative deri në platformën e bashkëqeverisjes, por nuk kam marrë asnjë argumentim të plotë dhe bindës ligjor.

Në vitin 2025 jam regjistruar në programin “MSC Inxhinieri Software” pranë Universitetit Barleti, ku aktualisht kam për të mbrojtur vetëm tezën finale.

Në mars 2025 kam fituar kategorinë “Mësues Specialist” nga ASCAP me rezultat “Shkëlqyeshëm”. Në datën 02.09.2025, nëpërmjet procedurës “Lëvizje paralele me dëshirë”, jam transferuar në gjimnazin “John F. Kennedy”, Institut, për arsye afërsie me vendbanimin.

Në momentin e transferimit kam qenë në dijeni se ky institucion nuk kishte pozicion të plotësuar të Nëndrejtorit. Sipas Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve, unë nuk plotësoj kriterin e përcaktuar në nenin 2, pika “a”, të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023, duke argumentuar se nuk plotësoj kriteret si mësuese bazuar në nenin 57 të ligjit nr. 69/2012 të ndryshuar, për shkak të mungesës së diplomës “MSC”.

Ndërkohë, ligji nr. 69/2012, neni 55 pika 3, përcakton qartë se kandidati për Drejtor/Nëndrejtor duhet:

- të zotërojë kategorinë “Mësues i Kualifikuar”;
- dhe të jetë i certifikuar për drejtim.

Të dyja këto kritere unë i plotësoj. Vlerësoj se Udhëzimi nr. 22/2023 ka shtuar kritere në tejkallim të parashikimeve ligjore, duke krijuar paqartësi dhe interpretime kontradiktore administrative, të cilat po cenojnë të drejtat profesionale dhe integritetin tim si mësuese, është e pakuptueshme dhe diskriminuese që:

- të jem lejuar të ushtroj profesionin e mësuesit prej më shumë se 10 vitesh:

- të kem kaluar dy shkallë kualifikimi;
- të jem certifikuar për drejtim;
- të jem pjesë e sistemit arsimor me kontratë të përhershme;

por njëkohësisht të konsiderohem “e paplotësuar në kriteret si mësuese” vetëm në momentin e kandidimit për pozicion drejtues.

Nëse institucioni vlerëson se unë nuk plotësoj kriteret për të ushtruar profesionin e mësuesit, atëherë kërkoj që kjo të formalizohet institucionalisht. Në të kundërt, kërkoj të më njihet e drejta për të vijuar zhvillimin tim profesional dhe konkurrimin për pozicione drejtuese në sistemin arsimor.”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri:

- konstatimin e diskriminimit të saj nga ana e Gjimnazit “John F. Kennedy”, Tiranë, për shkak të gjendjes arsimore;
- rishqyrtimin e vendimit të skualifikimit të saj;
- dhënien e një interpretimi të qartë dhe të argumentuar ligjor lidhur me vlefshmërinë e formimit tim akademik.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës të paraqitur nga ankuesja, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga

Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Në vijim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës nr. 972/1 prot., datë 05.06.2026, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Gjimnazi “John F. Kennedy”, Tiranë, sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje për sa më lart, Gjimnazi “John F. Kennedy”, Tiranë, përmes shkresës³ nr. 172 prot., datë 17.06.2026, informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndër të tjera se: *“...Bazuar në udhëzimin Nr. 22, datë 13.11.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit në TAP, drejtori i shkollës i dorëzon Komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikantëve për vendin e lirë të nëndrejtorit, aplikimet e ardhura (fizikisht apo email), të printuara.*

Drejtori i TAP nuk bën pjesë në komision.

Pasi komisioni shpall rezultatet e kandidatëve dhe pas fazës së ankimimeve, drejtori i IAP interviston dy kandidatët me më shumë pikë, të cilët komisioni i ka renditur në vend të parë dhe të dytë, dosjet e të cilëve i dorëzohen me procesverbal dhe bëhen pjesë e dosjes për procedurat e emërimit të nëndrejtorit.

Komisioni mban korrespondencën me kandidatët nëpërmjet adresës zyrtare të shkollës (postare ose elektronike).

Në rastin konkret: Kualifikimi dhe skualifikimi i dosjeve është bërë nga ana e Komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikantëve për vendin e lirë të nëndrejtorit, i cili ka dhënë dhe arsyetimin përkatës, duke pritur afatet e ankimimeve, sikurse dhe udhëzimi e përcakton. Të gjitha ankesat e znj. F. Xh. (printimet e emaileve bashkëngjitur), ngrenë të njëjtin pretendim dhe të gjitha përgjigjet e kthyer nga Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikantëve për vendin e lirë të nëndrejtorit, janë në një argumentim (printimet e emaileve bashkëngjitur). Sipas komisionit, arsyeja e skualifikimit është:

“Mungon diploma e ciklit të dytë “Master” me 120 kredite ECTS, në fushën e mësuesisë, që lidhen me programin e studimit të ciklit të parë, sipas përcaktimeve të pikës 3, neni 57, Ligji 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe germës a, neni 2 i Udhëzimit Nr. 22, datë 13.11.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar”.

E thënë shkurtimisht: Skualifikimi i dosjes është bërë nga Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikantëve për vendin e lirë të nëndrejtorit, ku në përbërje të tij ka pasur dhe përfaqësues nga zyra juridike e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë. (Komunikimet e komisionit me kandidatët, printuar bashkëngjitur).

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 972/2 prot., datë 18.06.2026.

Në gjimnazin “John F. Kennedy”, nuk ka pasur raste të tjera të skualifikimit të kandidatëve për pozicionin e nëndrejtorit.

Bashkëngjitur këtij raporti, ju vëmë në dispozicion gjithë dokumentacionin që përmban dosja e procedurave për emërimin e nëndrejtorit të shkollës”.

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, përmes shkresës⁴ nr. 5524/1 prot., datë 24.06.2026, informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndër të tjera se: “...Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit ka kryer një rishqyrtim të plotë të dokumentacionit të depozituar nga kandidatja, si dhe të pretendimeve të ngritura në ankesë, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon procedurat e konkurrimit për funksionet drejtuese në institucionet publike arsimore parauniversitare.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe bazës ligjore përkatëse, Komisioni konstaton se vendimi për moskualifikimin e kandidatës është marrë në respektim të plotë të parimit të ligjshmërisë, të parimit të barazisë në konkurrim dhe të detyrimit për zbatimin e njëtrajtshëm të kriterëve ligjore për të gjithë kandidatët.

Ankuesja parashton se ka përfunduar studimet Bachelor në degën “Teknologji Informacioni” pranë Universitetit të Vlorës, studimet “Master Profesional në Pedagogji”, profili “Didaktikë”, me 90 kredite pranë Albanian University, se është licencuar si Mësuese Informatike, zotëron kategoritë e kualifikimit “Mësues i Kualifikuar” dhe “Mësues Specialist”, si dhe certifikimin për drejtim. Këto elemente janë kontestuar nga Komisioni dhe janë marrë në konsideratë gjatë verifikimit të dokumentacionit.

Megjithatë, procedura e verifikimit të dokumentacionit nuk konsiston në vlerësimin e meritave profesionale të kandidatit, por në verifikimin objektiv të përmbushjes së kriterëve ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Lidhur me arsyen e moskualifikimit të znj. F. Xh., sqarojmë se vendimi i Komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit është mbështetur në nenin 57, pika 3, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 2, pika “a”, të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023.

Neni 57, pika 3, i ligjit nr. 69/2012 përcakton se:

“Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët dhe për arsimin e mesëm të lartë ka fituar diplomë të ciklit të parë “Bachelor” në fushën/lëndët e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë dhe diplomë të ciklit të dytë “Master” me 120 ECTS në fushën e mësuesisë, që lidhet me programin e studimit të ciklit të parë.”

Ndërkohë, neni 2, pika “a”, e Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023, përcakton se kandidati për drejtor ose nëndrejtor duhet:

“Të zotërojë arsimin si mësues sipas përcaktimeve në nenin 57 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 972/2 prot., datë 18.06.2026.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga znj. F. Xh. rezulton se ajo zotëron diplomë Bachelor në degën “Teknologji Informacioni” dhe diplomë “Master Profesional në Pedagogji”, profili “Didaktikë”, me 90 kredite.

Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit nuk ka vënë në diskutim vlefshmërinë e diplomave, licencimin e saj si mësuese, kategoritë e kualifikimit “Mësues i Kualifikuar” dhe “Mësues Specialist”, apo certifikimin për drejtim. Megjithatë, gjatë verifikimit paraprak, Komisioni ishte i detyruar të verifikonte nëse dokumentacioni i paraqitur provonte përmbushjen e kushtit të parashikuar në nenin 2, pika “a”, të Udhëzimit nr. 22, në lidhje me nenin 57 të ligjit nr. 69/2012.

Pikërisht mbi këtë element është mbështetur vendimi i moskualifikimit. Vendimi nuk është bazuar në përvojën profesionale të kandidates, në kategorinë e kualifikimit, në licencimin apo në ndonjë karakteristike personale të saj, por vetëm në vlerësimin e përmbushjes së kriterit ligjor të kërkuar nga neni 57 i ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.” dhe neni 2 i Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar”.

Parimi i ligjshmërisë, i cili përbën një nga parimet themelore të veprimtarisë administrative, kërkon që çdo organ administrativ të veprojë vetëm në bazë dhe në zbatim të ligjit. Për këtë arsye, Komisioni nuk mund të shmangë ose të mos zbatojë kriteret e përcaktuara nga ligji, edhe në rastet kur kandidati disponon eksperiencë të konsiderueshme profesionale apo kontribute të spikatura në sistemin arsimor.

Lidhur me pretendimin për diskriminim, theksojmë se ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” kërkon ekzistencën e një trajtimi më pak të favorshëm krahasuar me persona të tjerë që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme. Nga shqyrtimi i rastit konkret nuk rezulton që znj. F. Xh. të jetë trajtuar ndryshe nga kandidatët e tjerë pjesëmarrës në procedurë.

Të gjithë kandidatët janë vlerësuar sipas të njëjtave kriteresh ligjore, të njëjtit standard verifikimi dhe të njëjtave kërkesa dokumentare. Nuk është aplikuar asnjë kriter shtesë ndaj ankueses dhe nuk është bërë asnjë dallim mbi bazën e gjendjes arsimore apo të ndonjë karakteristike tjetër të mbrojtur nga ligji.

Pretendimi i ankueses se zotëron përvojë të gjatë profesionale, kategori kualifikimi, licencim për ushtrimin e profesionit dhe certifikim për drejtim nuk përbën provë diskriminimi. Këto elemente janë vlerësuar dhe njohur nga Komisioni, por ato nuk mund të zëvendësojnë kërkesat formale ligjore të procedurës së konkurrimit.

Gjithashtu, pretendimi se institucione të tjera mund të kenë mbajtur qëndrime të ndryshme administrative nuk përbën element diskriminimi. Çdo procedurë administrative zhvillohet mbi bazën e dokumentacionit konkret dhe rrethanave specifike të secilit rast.

Për sa më sipër, vlerësojmë se vendimi për moskualifikimin e znj. F. Xh. është marrë në përputhje me ligjin nr. 69/2012, të ndryshuar, me Udhëzimin nr. 22, datë 13.11.2023, si dhe me parimet themelore të veprimtarisë administrative... ”.

2. Sakaq, Komisioneri përmes e-mail-it datë 10.07.2026, i përcolli ankueses një kopje të shkresës së Gjimnazit “John F. Kennedy”, Tiranë, si dhe kërkoi parashtrime me shkrim nga ana e saj.
3. Me e-mail-in datë 10.07.2026, ankuesja i përcolli Komisionerit një kopje të dokumentit “Vërtetim Notash”, nr. 785 prot., datë 02.07.2026, lëshuar nga Universiteti Barleti, përmes së cilit vërtetohet se znj. F. Xh. gjatë periudhës tetor 2024 - qershor 2026 ka ndjekur studimet universitare të ciklit të dytë në programin e studimit master i shkencave në informatikë të aplikuar dhe i ka përfunduar ato më datë 30.06.2026.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të subjektit ankues

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “*shkakun e mbrojtur*”.

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e saj në punësim nga ana e Gjimnazit “John F. Kennedy”, Tiranë dhe më konkretisht në lidhje me procedurën e konkurrimit për vendin e lirë të punës për pozicionin Nëndrejtor në këtë institucion arsimor.

Nga këqyrja dhe analizimi i dokumentacionit të administruar, rezulton se:

- ankuesja, znj. F. Xh., aktualisht është mësuese e lëndës TIK në gjimnazin “John F. Kennedy”, Tiranë;
- ka përfunduar ciklin e parë të studimeve “Bachelor” në degën Teknologji Informacioni dhe ciklin e dytë “Master Profesional” me 90 kredite ECTS në fushën e mësuesisë;
- ka fituar kategorinë “Mësues i Kualifikuar”, nuk ka masë disiplinore në fuqi dhe është certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor.

Me shkresën nr. 114 prot., datë 28.04.2026, Gjimnazi “John F. Kennedy”, ka njoftuar Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, për hapjen e një vendi pune vakant, në pozicionin e nëndrejtorit të shkollës.

Mbështetur në këtë njoftim, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, me shkresën nr. 4727 prot., datë 29.04.2026, ka shpallur vendin e lirë të punës për pozicionin Nëndrejtor në Gjimnazin “John F. Kennedy”, Tiranë, me kushtet:

- a. të zotërojë arsimin si mësues sipas nenit 57, të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar;

- b. të ketë të paktën kategorinë “Mësues i Kualifikuar”, me vlerësim jo më pak se “Mirë”;
- c. të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- d. të jetë i certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve.

Ankuesja ka depozituar aplikimin dhe dokumentacionin shoqërues më datë 06.05.2026, brenda afatit të përcaktuar në njoftim.

Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 55, pika 3, përcakton ndër të tjera se: *“Kandidati për drejtor dhe nëndrejtor i institucionit arsimor duhet të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar” dhe të jetë i pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar. Certifikimi i kandidatit për drejtor dhe nëndrejtor i institucionit arsimor kryhet pas zhvillimit të trajnimit të detyrueshëm përgatitor në shkollën e drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor...”*.

Ndërsa, neni 57, i ligjit nr. 69/2012, në pikën 3 të tij, parashikon se: *“Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët dhe për arsimin e mesëm të lartë duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë “Bachelor” në fushën/lëndët e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë dhe diplomën e ciklit të dytë “Master” me 120 ECTS në fushën e mësuesisë, që lidhet me programin e studimit të ciklit të parë.”*

Në mbështetje të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Arsimit dhe Sportit, ka miratuar Udhëzimin Nr. 22, datë 13.11.2023 *“Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar”*.

Neni 2, i Udhëzimit sipërcituar, përcakton se: *“Kandidati për drejtor apo nëndrejtor i IPAP-së duhet të plotësojë kushtet si vijon:*

- a) *të zotërojnë arsimin si mësues sipas përcaktimeve në nenin 57, të ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;*
- b) *të ketë të paktën kategorinë “Mësues i Kualifikuar”, me vlerësim jo më pak se “Mirë” në kualifikimin e fundit;*
- c) *të mos ketë masë disiplinore në fuqi ndaj tij;*
- d) *të jetë i certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar, ose të jetë pranuar për ta kryer atë”*.

Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ana e Gjimnazit “John F. Kennedy”, Tiranë, rezulton se: procedura e konkurrimit për pozicionin Nëndrejtor është zhvilluar nga një

Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, i ngritur sipas Udhëzimit nr. 22/2023⁵, në përbërje të të cilit ka qenë edhe përfaqësues i zyrës juridike të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë. Nga aktet e administruara rezultoi se më datë 12.05.2026, Komisioni ka marrë në dorëzim 7 (shtatë) dosje të aplikantëve për pozicionin e nëndrejtorit të Gjimnazit “John F. Kennedy”.

Sa më sipër, Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, referuar pikës 9 të Udhëzimit Nr. 22, datë 13.11.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar”, kryen këto detyra:

a) bën shqyrtimin paraprak të dokumentacionit të paraqitur në dosjen e aplikimit, brenda 2 (dy) ditëve pune nga mbledhja e Komisionit, sipas shtojcave 1 dhe 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) njofton me shkrim/e-mail aplikantët për mangësitë e konstatuara në dokumentacion. Aplikanti bën plotësimin e dokumentacionit brenda tri ditëve pune nga data e njoftimit;

c) pas përfundimit të afatit, sipas shkronjës “b” të kësaj pike, liston aplikantët të cilët kanë dokumentacionin e plotë dhe të saktë dhe vlerëson me pikë aplikantët e pranuar, kandidatë për nëndrejtor të IPAP-së, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi, brenda dy ditëve pune nga listimi i aplikantëve;

d) realizon intervistën e strukturuar me secilin kandidat për fushat e njohurive dhe aftësitë për drejtimin e institucionit. Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10, brenda një dite pune;

e) harton tabelat e pikëve dhe rendit kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës;

f) brenda tri ditëve pune, pas përfundimit të intervistave, shpall në këndin e njoftimeve të IPAP-së tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës 7, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

10. Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankim me shkrim para Komisionit brenda tri ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit. Komisioni shqyrton ankesat brenda një dite pune.

11. Kryetari i Komisionit i dorëzon drejtorit të IPAP-së dosjet e aplikimit dhe vlerësimet me pikë për dy kandidatët me më shumë pikë. Kopjet e këtyre dokumenteve dhe dosjet e aplikantëve të tjerë ruhen në arkivin e institucionit në përputhje me afatet kohore të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arkivat.

⁵ Neni 5, pika 1, i udhëzimit përcakton se: “Komisioni i shqyrtimit dhe i vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e nëndrejtorit të IPAP-së, në vijim “Komisioni”, ngrihet nga drejtori i IPAP-së, në përputhje me parashikimet e pikës 2, të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar dhe përbëhet nga anëtarët si vijon:

a) kryetari i bordit të IPAP-së;

b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP-së;

c) dy mësues të IPAP-së;

d) një përfaqësues i ZVAP-së...”.

Mbështetur në procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e nëndrejtorit të Gjimnazit “John F. Kennedy”, Tiranë, i ngritur me urdhrin nr. 59, datë 11.05.2026, rezulton se ankuesja është skualifikuar, pasi i mungon diploma e ciklit të dytë të studimeve “Master”, me 120 kredite ECTS, në fushën e mësuesisë, siç kërkohet shprehimisht nga neni 57, pika 3, i ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar.

Lidhur me këtë, ankuesja me e-mail-in datë 18.05.2026, është njoftuar nga Gjimnazi “John F. Kennedy” se aplikimi i saj është skualifikuar.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton gjithashtu se, Kryetari i Komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e nëndrejtorit të Gjimnazit “John F. Kennedy”, Tiranë, më datë 28.05.2026, i ka dorëzuar drejtorit të shkollës, dosjet e aplikimit dhe vlerësimet me pikë për dy kandidatët me më shumë pikë, përkatësisht kandidatët V. H. dhe U. M. Në përfundim me Vendim Nr. 61, datë 02.06.2026, është shpallur fitues për pozicionin nëndrejtor në Gjimnazin “John F. Kennedy”, Tiranë, shtetasi U. M.

Shtetasi U. M., ndryshe nga ankuesja, referuar në dokumentacionin e administruar, plotëson kriterin e parashikuar në nenin 57, pika 3, të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar, duke zotëruar diplomën e ciklit të dytë “Master” me 120 kredite ECTS, në një fushë studimi që lidhet me programin e studimit të ciklit të parë, si dhe plotëson kushtet e tjera të parashikuara në nenin 2 të Udhëzimit nr. 22/2023 (kategoria “Mësues i Kualifikuar”, mungesa e masës disiplinore në fuqi, certifikimi nga Shkolla e Drejtorëve).

Sakaq, rezulton se ankuesja, si mësuese e arsimit të mesëm të lartë, veç diplomës së ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në fushën/lëndët e arsimit të mesëm të lartë, duhet të zotëronte edhe diplomën e ciklit të dytë “Master” me 120 ECTS në fushën e mësuesisë, që lidhet me programin e studimit të ciklit të parë. Duke qenë se ankuesja zotëronte vetëm diplomën e ciklit të dytë “Master Profesional” me 90 ECTS në fushën e mësuesisë, deri në momentin e aplikimit, nuk ka përmbushur kushtet për të aplikuar për vendin e lirë të punës për pozicionin Nëndrejtor në Gjimnazin “John F. Kennedy”, Tiranë.

Diskriminimi përkuftizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të saj që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i ankesës, nuk

evidentohet se ankuesja është përballur nga punëdhënësi me një trajtim të diferencuar apo të padrejtë, sa i përket konkurrimit për vendin e lirë të punës për pozicionin Nëndrejtor në Gjimnazin “John F. Kennedy”, Tiranë.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm nga ana e Gjimnazit “John F. Kennedy”, sa i përket procedurave të konkurrimit për pozicionin vakant të punës, Nëndrejtor.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Gjimnazit “John F. Kennedy”, Tiranë, për shkakun e pretenduar nga ankuesja dhe për rrjedhojë nuk provohet se Gjimnazi “John F. Kennedy”, Tiranë, ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 e 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të F. Xh., për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Gjimnazit “John F. Kennedy”, Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

(Shkaku: Gjendja arsimore)
(Fusha: Punësim)